

VENDIM
Nr.626, datë 11.6.2009

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.277, DATË 18.7.1997 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRFITIMET NGA STATUSI I TË VERBËRIT”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5 të ligjit nr.8089, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbërit”, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 12 të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fjalinë e parë të pikës 4 të vendimit nr.277, datë 18.7.1997 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shuma “... 8700 (tetë mijë e shtatëqind) lekë...” zëvendësohet me “... 9800 (nëntë mijë e tetëqind) lekë...”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, në shumën 123 000 000 (njëqind e njëzet e tre milionë) lekë, të përballohen nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

3. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Financave, Shërbimi Social Shtetëror dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 qershor 2009.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha